



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM DURRËS

Nr. 3800 Prot.

Durrës, më 25.07.2023

**SHPALLJE PËR LËVIZJEN PARALELE, NGRITJEN NË DETYRË DHE PRANIMIN  
NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR  
NË POZICIONIN SHEF SEKTORI I TEKNOLOGJISE SË INFORMACIONIT ,  
STATISTIKAVE DHE MARËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, MEDIAN DHE ME  
JASHTË**

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56/7, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimit nr.622, datë 10.12.2020, "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", Vendimit nr.35, datë 24.07.2023 të Këshillit të Gjykatës, Gjykata e Shkallës Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, shpall procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë drejtuese, për pozicionin:

**1 (një) pozicion – SHEF SEKTORI I TEKNOLOGJISE SË INFORMACIONIT ,  
STATISTIKAVE DHE MARËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, MEDIAN DHE ME  
JASHTË**

**kategoria III-2**

*Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë drejtuese.*

**Për të tre procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë drejtuese) aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

**LËVIZJE PARALELE:**

**08 Gusht 2023**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

**NGRITJE NË DETYRË**

**15 Gusht 2023**

**Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin  
SHEF SEKTORI I TEKNOLOGJISE SË INFORMACIONIT , STATISTIKAVE DHE  
MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, MEDIAN DHE ME JASHTË**

- a) Menaxhon punën e sektorit;
- b) Koordinon dhe ndan detyrat në sektor;
- c) Menaxhon punën për mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave në gjykatë, të mbajtura në formë elektronike nëpërmjet sistemeve kompjuterike, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;
- ç) Menaxhon punën ruajtjen e rregullt të statistikave të gjykatës;
- d) Kontrollon shkallën e zbatimit të parimeve të cilësisëstatistikore, si dhe harton raporte të veçanta dhe periodike të cilësisë për çdo tregues dhe/ose aktivitet statistikor të parashikuar;
- dh) Mbikëqyr grumbullimin, përpunimin dhe mbajtjen e të dhënave statistikore dhe për metodikën dhe mënyrën e mbajtjes së statistikës gjyqësore;
- e) mirëmbajtjen dhe kontrollin e sistemit kompjuterik, elektronik, të teknologjisë së informacionit, si dhe për ruajtjen dhe përpunimin e statistikave të gjykatës;
- ë) Ndihmon kancelarin në procesin e rekrutimit të punonjësve të tjerë të gjykatës sipas ligjit, duke përgatitur të gjitha dokumentet dhe aktet e nevojshme për këtë qëllim;
- f) Merr masa për riparimin dhe shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë së informacionit. g) Kontrollon përdorimin me korrektësi të pajisjeve të teknologjisë së informacionit.
- gj) Kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- h) Kujdeset që shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë;
- i) Shërbimi i marrëdhënieve me publikun ndërvepron dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e marrëdhënieve me publikun pranë gjykatave dhe kërkon mendimin e tij kur është e nevojshme;
- j) Shërbimet e marrëdhënieve me publikun ushtrohen nga ose nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun;
- k) Kryen detyra të tjera, sipas urdhrave apo porosive të kryetarit, kancelarit apo Këshillit të Gjykatës.

**I. LËVIZJA PARALELE**

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësor të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.*

## **I.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a. Të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon(*dokument nga institucioni*),
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi(*dokument nga institucioni*);
- c. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

Arsimi: Diplomë e nivelit “Master Shkencor” në Shkenca të Teknologjisë së Informacionit ose Juridike.

Përvoja: Të ketë kryer të paktën 3 vjet praktikë profesionale

Aftësi të tjera: Të zotërojë gjuhë të huaj - preferencë për gjuhët e BE-së;

Njohuri shumë të mira të organizimit gjyqësor dhe aktivitetit të gjykatave. Aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve; aftësi për të shkëmbyer ide, mendime për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

## **I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dokumentet si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar (CV të përshkrimit të karrierës) duke saktësuar ndër të tjera edhe kontaktet e sakta: email/adresë postare/numër telefoni.
- b. Fotokopje të diplomës së arimit të lartë (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- a. Formular të vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- f. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- g. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h. Aktin e deklarimit lidhur me statusin e nëpunës civil gjyqësor të konfirmuar në detyrë, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: *Lagjia Nr 2 Rruga “Aleksandër Goga Durrës” nëpërmjet shërbimit postar brenda datës **08.08.2023**.*

### **Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.**

*Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.*

### **I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **09.08.2023**, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të KLGJ [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të Gjykatës, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

### **I.4. FUSHA E NJOHURIVE, AFTESITE DHE CILESITE MBI TE CILAT DO TE ZHVILLOHET INTERVISTA**

- Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar;
- Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “ Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- Ligji nr.98/2016 “ Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 i ndryshuar me ligjin Nr 48/2012 “ Për mbledhjen e të dhënave personale”
- Ligji nr 9880 datë 25.02.2008 “ Për nënshkrimin elektronik “
- Ligji nr.10325 datë 23.09.2010 “ Për bazën e të dhënave shtetërore”
- Ligji nr 9918 datë 19.05.2008 “ Për komunikimin elektronik në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr.152/2013 “ Për nëpunësit civil”, i ndryshuar;

### **I.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Vlerësimi profesional** për kandidatët fitues të fazës së parë *do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej tyre dhe intervistës*, nga Këshilli i Gjykatës sipas një sistemi pikëzimi.

#### **Kandidatët do të vlerësohen:**

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

### **I.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të KLGJ [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të Gjykatës.

## **II. KONKURIMI, NËPËRMJET PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË**

*(Në rast se pozicioni i lirë i shpallur, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, nuk është plotësuar, pra rezulton i lirë, atëherë ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë).*

*Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunës civil gjyqësor të një kategorie paraardhëse, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.*

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë si vijon:**

- Të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, të një kategorie paraardhëse (*dokument nga institucioni*).
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (*dokument nga institucioni*).
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë".
- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a. Arsimi: Diplomë e nivelit "Master Shkencor" në Shkenca të Teknologjisë së Informacionit ose Juridike.
- b. Përvoja: Të ketë kryer të paktën 3 vjet praktikë profesionale
- c. Aftësi të tjera: Të zotërojnë gjuhë të huaj - preferencë për gjuhët e BE-së; Njohuri shumë të mira të organizimit gjyqësor dhe aktivitetit të gjykatave. Aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve; aftësi për të shkëmbyer ide, mendime për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

**II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës Shkallës Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dokumentet si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar (CV të përshkrimit të karrierës) duke saktësuar ndër të tjera edhe kontaktet e sakta: email/adresë postare/numër telefoni.
- b. Fotokopje të diplomës së arsmiit të lartë (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë); Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- d. Vërtetim të gjendjes shëndetësore
- e. Formular të vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- f. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- g. Aktin e deklaramit lidhur me statusin e nëpunës civil gjyqësor të konfirmuar në detyrë, të një kategorie paraardhëse;
- h. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: *Lagjia Nr 2 Rruga "Aleksandër Goga Durrës* nëpërmjet shërbimit postar brenda datës **15.08.2023**.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

### **1.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën 16.08.2023, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të KLGJ [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të Gjykatës, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

### **1.4. FUSHA E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

- Ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar;
- Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “ Për rregullat e etikës në Administratën Publike”;
- Ligji nr.98/2016 “ Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 i ndryshuar me ligjin Nr 48/2012 “ Për mbledhjen e të dhënave personale”
- Ligji nr 9880 datë 25.02.2008 “ Për nënshkrimin elektronik “
- Ligji nr.10325 datë 23.09.2010 “ Për bazën e të dhënave shtetërore”
- Ligji nr 9918 datë 19.05.2008 “ Për komunikimin elektronik në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr.152/2013 “ Për nëpunësit civil”, i ndryshuar;

### **1.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

#### **Kandidatët do të vlerësohen:**

1. 70 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë:

a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;

b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,

c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

2. 30 pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

### **1.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të KLGJ [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të Gjykatës.

### **III. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË DREJTUESE**

*Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë drejtuese.*

#### **III.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA**

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:**

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a. Arsimi: Diplomë e nivelit “Master Shkencor” në Shkenca të Teknologjisë së Informacionit ose Juridike.
- b. Përvoja: Të ketë kryer të paktën 3 vjet praktikë profesionale
- c. Aftësi të tjera: Të zotërojë gjuhë të huaj - preferencë për gjuhët e BE-së; Njohuri shumë të mira të organizimit gjyqësor dhe aktivitetit të gjykatave. Aftësi për të ofruar drejtim teknik, për të koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve; aftësi për të shkëmbyer ide, mendime për të argumentuar propozimet përkatëse; aftësi shumë të mira organizimi, komunikimi dhe prezantimi.

#### **III.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

- a. Jetëshkrim i plotësuar (CV të përshkrimit të karrierës) duke saktësuar ndër të tjera edhe kontaktet e sakta: email/adresë postare/numër telefoni.
- b. Fotokopje të diplomës së arsimit të lartë (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f. Formular i vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

- h. Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces penal;
- i. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: *Lagjia Nr 2 Rruga "Aleksandër Goga Durrës* nëpërmjet shërbimit postar brenda datës **22 .08.2023.**

**Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.**

### **III.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **27.08.2022**, KLGJ do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të Gjykatës listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë drejtuese, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë drejtuese dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

*Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Këshillin e Gjykatës, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.*

### **III.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- Ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; i ndryshuar;
- Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 " Për rregullat e etikës në Administratën Publike";
- Ligji nr.98/2016 " Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike".
- Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 i ndryshuar me ligjin Nr 48/2012 " Për mbledhjen e të dhënave personale"
- Ligji nr 9880 datë 25.02.2008 " Për nënshkrimin elektronik "
- Ligji nr.10325 datë 23.09.2010 " Për bazën e të dhënave shtetërore"
- Ligji nr 9918 datë 19.05.2008 " Për komunikimin elektronik në Republikën e Shqipërisë"
- Ligji nr.152/2013 " Për nëpunësit civil", i ndryshuar;

### **III.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen:**

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.



Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë drejtuese, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë drejtuese:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të Gjykatës.

### **Këshilli i Gjykatës Shkallës Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës**

- *V.O.: Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.85, datë 11.03.2021 "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor" të Këshillit të Lartë Gjyqësor publikuar në faqen zyrtare të tij [www.klgj.al](http://www.klgj.al)*